


BIBLIOTEKA
SHITETIT

92
—
Z 28



QEMAL
MATAJ

Ramadan Zaskaci

96
228


QEMAL MATAJ

RAMADAN ZASKOCI



23546

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»



Ramadan Selman Zaskoci, (1860-1914)

**«Kur ndodhesh në këto krahina kresh-
nike e të bukura të atdheut tonë, gjithsecili
nga ne kujton me krenari se megjithëse për
shekuj me radhë vendi ynë ka vuajtur nën
okupatorët e huaj turq, austro-hungarezë,
italianë etj., ka pasur te ne, vende si këto
male të paepura që u bënë kështjella nga
ku populli mbronte lirinë, jetën e nderin e
tij dhe i tmerronte pushtuesit».¹⁾**

ENVER HOXHA

1) Vepra, Vëll. 10, fq. 30. (Nga fjala para popullit të Kukësit, në mitingun e organizuar me rastin e vizitës së sh. Enver në zonat e Veriut).

LUMA

Në analet e historisë, në kronikat e ngjarjeve, në këngët popullore dhe nga vetë populli, të shtatë krahinat e nahijes¹⁾ së Lumës, janë njohur dhe trajtuar me një emër simbolik — Luma.

Këtë emër të thjeshtë kjo krahinë e ka marrë nga emri i lumit të vogël Luma, të cilin Johan Georg fon Hahn, në veprën e tij «Udhëtim nëpër krahinën e Drinit dhe të Vardarit», e ka përmendur me emrin «Përroi i Lumës»¹⁾.

Lugina e Lumës rrethohet nga malet e thepisura shkëmbore, që veçohen nga njëri-tjetri prej grykash të thella, të cilat shërbejnë për t'u ngjitur në rrafshnaltat e maleve të Gjallicës, Koritnikut, Kallabakut, Tejës, Runës, Malit të Kolosianit e deri në lartësitë e Korabit. Të tëra këto gryka të thella të kësaj krahine përshkohen nga ujërat e lumenjve të Drinit të Zi, të Drinit të Bardhë, të Lumës, të Lapave, Velshicës dhe të shumë përrënjeve.

Malet, luginat, rrafshnaltat dhe lumenjtë e Lumës, gjatë gjithë kohërave kanë shërbyer si kështjella

1) Johan Georg Von Hahn. «Udhëtim nëpër krahinën e Drinit dhe të Vardarit» 1867. AIH-RPSSH, Tiranë, Dosja Nr. A-IV, 325, f. 138.

natyrore për mbrojtjen e popullsisë së fshatrave të krahinës së Lumës.

Pleqtë e mocëm tregojnë se stërgjyshërit tanë nuk kishin zënë vend rastësisht ndër këto male, luginë, gryka dhe rrafshnalta. Ata ishin vendosur aty me qëllim që të jetonin të lirë dhe të ishin të mbrojtur në çdo kohë nga sulmet e rrebeshet e vazhdueshme të pushtuesve të huaj, që e patën sulmuar këtë krahinë ashtu si gjithë vendin tonë gjatë gjithë shekujve.

Malësorët e Lumës ashtu si gjithë shqiptarët kanë luftuar gjithmonë që të mbeten të lirë dhe të qetë në trojet e tyre. Mirëpo, prej shekujsh krahinën e Lumës e patën sulmuar herë pas here ushtri të shumta të shteteve të ndryshme shoviniste të Ballkanit, të cilat kanë pasur si qëllim pushtimin e gjithë Shqipërisë.

Ndër luftërat më të ashpra që kanë bërë malësorët e Lumës kundër pushtuesve të huaj, jehona e të cilëve nuk është shlyer deri në ditët e sotme, kanë qenë revolta e udhëhequr nga Mahmut Dac Kalisi në periudhën e Tanzimatit, luftërat e viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e të periudhës pas saj, si dhe kryengritjet e vegjëlisë lumjane në vitet 1903, 1904, 1907, 1909, 1910 dhe në mënyrë të veçantë ato të periudhës 1912-1913 kundër pushtuesve osmanë dhe shovinistëve serbomëdhenj.

Luftërat që kanë zhvilluar malësorët e Lumës kundër pushtuesve të huaj gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX pena e poetit i ka skalitur me rreshtat e këtyre vargjeve:

*«...S'hyn dot në Lumë, qen zuzar,
manovë anadollaku,*

*Rrok pushkën qindvjeçari,
dhe shtatvjeçar çunaku...»¹⁾*

Gjatë këtyre luftërave dhe kryengritjeve, nga gjiri i popullit të krahinës së Lumës dolën dhe u shquan si udhëheqës ushtarakë prijësa popullorë dhe luftëtarë të vegjëlisë së varfër lumjane si Mahmut Dac Kalisi, Ejup Topojani, Sahit Gega, Ramadan Zaskoci, Islam Spahia, Shaqir Palushi, Hoxhë Caka, Imer Sula, Halim Bardhoci, Imer Sufa, Jemin Gjana, Ramadan Çiku, Hoxhë Mehmeti dhe shumë të tjerë, të cilët në krye të forcave të vegjëlisë lumjane u shkak-tuan disfata të vazhdueshme pashallarëve të ushtrisë osmane dhe kralëve të Sërbisë.

Ndër 49 fshatrat e krahinës së Lumës bën pjesë edhe fshati i Mamëzit. Ky fshat ka qenë vendbanimi i familjes së Selman Brahës, prej së cilës ka dalë patrioti, prijësi i vegjëlisë së varfër të malësorëve lumjanë, Ramadan Zaskoci, që hyri në historinë e krahinës së Lumës me të shtënat e kapaklisë në vitin 1878, kur kreu aksionin e parë të armatosur të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Ramadan Zaskoci, që rridhte nga shtresat e varfëra lumjane luftoi pa iu dridhur pushka për 36 vjet me radhë së bashku me luftëtarët e krahinës së Lumës që ai i udhëhoqi në luftë kundër pushtuesve osmanë dhe të ushtrive gjakatare të shovinistëve serbomëdhenj.

Në këtë mënyrë Ramadani shumë shpejt hyri në radhët e udhëheqësve popullorë të shquar të kra-

1) Lasgushi Poradeci. — Revista «Nëntori», Nr. 12, Tiranë 1976.

hinës së Lumës ku së bashku me ta luftoi kundër pushtuesve të huaj.

Historia e familjes së këtij luftëtari të vegjëlisë lumjane, është e njëjtë me jetën e shumicës së familjeve të tjera të krahinës së Lumës.

Fshati Mamëz shtrihet në një rrafshinë të ulët, në mes të kodrave, në anën verilindore të krahinës së Tejdrinës.

Në këtë fshat lindi dhe u rrit Selman Braha, i ati i Ramadan Zaskocit.

Selman Braha ishte bir i një malësori të thjeshtë, i njohur në krahinën e tij dhe në tërë Lumën për trimëritë në luftërat kundër ushtrive të pushtuesve osmanë.

Për shkak të një gjaku Selman Braha, siç përcaktohej edhe nga ligjet e egra të Kanunit të Lekë Dukagjinit ishte i detyruar të rrinte mbyllur në shtëpinë e tij. Një jetë e tillë e detyroi Selmanin që në vitin 1859 të largohej nga fshati i Mamëzit me gjithë gruan dhe djalin 5-vjeçar, Rexhën, dhe të merrte rrugën për në Kosovë.

Pas shumë përpjekjesh, mundimesh dhe vështirësish, Selman Braha u vendos në fshatin shqiptar Zaskok, gjysmë ore larg qytetit Ferizaj.

Si kudo në Shqipëri edhe në krahinat kryengritëse të Kosovës, të Lumës, dhe në fshatrat e Fushë-Ferizajt vazhdonte rezistenca e armatosur e masave popullore kundër zbatimit të reformave të Tanzimatit.

Selman Braha mori pjesë në kryengritjen e fshatarëve të Fushë-Ferizajt që shpërtheu në gjysmën e dytë të vitit 1860. Në disa përpjekje të kryengritësve të Fushë-Ferizajt me forcat ushtarake të ekspeditave

ndëshkimore të ushtrisë turke. Selman Braha shquhet për guxim dhe trimëri të rrallë.

Administrata osmane e Vilajetit të Kosovës u detyrua që të dërgonte përforcime të reja të forcave ushtarake për të shtypur dhe shpërndarë me armë forcat kryengritëse kundër sundimit osman.

Pas zhvillimit të disa betejave të ashpra dhe të përgjakshme midis të dy palëve, forcat ushtarake të ekspeditave ndëshkimore të ushtrisë turke, të shumta në numër dhe të pajisura me armë moderne, e shtypën kryengritjen me zjarr e hekur me gjithë rezistencën e madhe që bënë kryengritësit.

Shtypja e kryengritjes si në të gjitha fshatrat e Fushë-Ferizajt, edhe në fshatin Zaskoc u shoqëruan me raprezalje. U arrestuan e u internuan shumë luftëtarë dhe prijësa popullorë së bashku me familjet e tyre. Midis luftëtarëve kryengritës të Zaskocit, që u dërguan në burgun e Prishtinës, ishte edhe Selman Braha me të shoqen e tij, Humen.

Administratorët turq të burgut të Prishtinës, malësorin e Lumës së bashku me gruan e tij i regjistruan me mbiemrin Zaskoci. Kështu pra, emri i fshatit të tij i dha Selmanit mbiemrin e ri, të cilin do ta mbanin fëmijët e tij. Me këtë mbiemër Selman Braha nga Mamëzi dhe fëmijët e tij do të bëheshin të njohur në gjithë Kosovën dhe në krahinën e Lumës në vitet e stuhishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe në luftërat që u zhvilluan për çlirimin kombëtar dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Jeta në burg ishte tepër e rëndë. Ata i torturonin thuajse çdo ditë për t'u hakmarrë për disfatat që kishin pësuar forcat ushtarake osmane nga luftëtarët kryengritës të Fushë-Ferizajt. Por për Selmanin jeta

e burgut ishte edhe më e vështirë sesa e shokëve të tij, jo vetëm për shkak të torturave, por edhe sepse nuk merrte asnjë lajm për gruan e tij — Humen shtazënë.

Në qelinë e errët të burgut të Prishtinës, midis hekurave dhe telave me gjemba, në mesin e muajit shtator të vitit 1860, në një natë të ftohtë, qetësia u prish nga të qarat e një fëmije që sapo kishte dalë në jetë. Nga qelia u dëgjuan thirrjet e grave: «Lindi djalë... djalë... djalë...!» Ky lajm u përhap në të gjitha qelitë e burgut nga të burgosurit e tjerë. Ata i dhanë lajmin edhe Selman Brahës, i cili u gëzua për së tepërmi, pasi kryengritësve shqiptarë iu shtua edhe një luftëtar i ardhshëm.

Djalit të porsalindur i vunë emrin Ramadan, ndërsa Selmani, në shenjë respekti dhe dashurie që kishte për fshatarët e Zaskokut i la mbiemrin e tij të ri Zaskoci me të cilin ai u bë i njohur në gjithë Kosovën dhe Lumën.

Pas kërkesave të vazhdueshme që bënë masat popullore të fshatrave të Fushë-Ferizajt dhe të gjithë krahinave të Kosovës për lirim të të burgosurve që ndodheshin nëpër burgjet e Turqisë, u arrit që në tetor të vitit 1860 administrata turke e Vilajetit të Kosovës të lironte disa prej tyre nga burgjet e Prishtinës, Prizrenit dhe të Shkupit, midis të cilëve edhe Selman Brahën së bashku me familjen e tij.

Sapo doli nga burgu, Selman Braha shkoi përsëri në Zaskok. Ai u prit me dashuri dhe ngrohtësi nga fshatarët e varfër të Zaskokut dhe me ndihmën e tyre arriti që të rindërtojë shtëpinë e tij, që ia kishin djegur forcat e ushtrisë turke pas burgosjes së tij.

Por me gjithë ndihmën që i dhanë, familja e